



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO
Nr. 540 Dt. 01.11.2021
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

PROPOZICIONET E GARAVE TË KUPËS SË KOSOVËS 2021-2022

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria ", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
RIPUBLICA E KOSOVËS



RUGOVË



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Konform Nenit 31. pika 3. e Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së, në mbledhjen e mbajtur më 01.11.2021 Nëntor 2021 aprovoi
PROPOZICIONET E GARAVE TË KUPËS SË KOSOVËS për edicionin 2021-2022

Neni 1

Me këto Propozicione përcaktohen dispozitat mbi organizimin dhe zhvillimin e garave për Kupën e Kosovës, edicioni 2021/22 (në tekstin e mëtejme - Garat për Kupë).

Me këto dispozita përcaktohet sistemi i garave për Kupën, kalendari, shpenzimet e garave, mënyra e paraqitjes, tërheqja e shortit, ankesat dhe gjithë ato veprime që do të bëhen në lidhje me garat për Kupë.

Neni 2

Federata e Basketbollit të Kosovës është organizatore e garave për Kupën e Kosovës në konkurrencën e meshkujve dhe të femrave. Me gara udhëheq Komesari i Garave.

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku C3 (Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë

Neni 3

Ekipeve fituese të finales së Kupës iu ndahen kupat dhe medaljet.

Ekipi fitues fiton të drejtën që të takohet në Superkupën e Kosovës 2022 me kampionin e Kosovës, por nëse ekipi fitues është njëkohësisht edhe kampion në ART Motion Superligën e Kosovës, në Superkupën e Kosovës do të takohet me finalistin e Kupës së Kosovës.

Neni 4

Garat për Kupën e Kosovës udhëheqin në bazë të dispozitave të Rregullores mbi organizimin e garave të basketbollit, Propozicioneve të Garave për Kupën e Kosovës dhe me Rregulloret e tjera të FBK-së.

Neni 5

Në garat për Kupë në mënyrë obligative marrin pjesë ekipet që bëjnë gara në ART Motion Superligë, Superligën e Femrave, Ligën e Parë të Femrave, Ligën e Parë dhe të Dytë të Meshkujve, si dhe grupet e qytetarëve të interesuar, lojtarët e të cilëve duhet të regjistrohen në FBK. Pjesëmarrës i garave të Kupës së Kosovës është çdo ekip që vepron dhe është nga territori i Kosovës.

Neni 6

Paraqitja e ekipeve dhe tërheqja e shortit bëhet më së paku 7 ditë para fillimit të garave, fillimin e të cilave e cakton Komesari i Garave dhe e verifikon Bordi i FBK-së.

Neni 7

Të drejtën e paraqitjes në ndeshjet në garat për Kupën e Kosovës e gëzojnë të gjithë lojtarët-lojtaret e regjistruar-a në bazë të Rregullores mbi regjistrimin e lojtarëve për vitin garues 2021/22.



RUGOVË



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Lojtari i cili regjistrohet në afatin e rregullt kalimtar veror apo mini-afatin dimëror ka të drejtë paraqitje pa marrë parasysh se a ka zhvilluar ndeshje për ndonjë ekip tjetër gjatë edicionit të Kupës së Kosovës 2021/22.
Nëse për ndonjërin ekip paraqitet lojtari-ja, që më parë nuk është regjistruar, ekipi i tij e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 20:0.

Neni 8

Garat për Kupën e Kosovës zhvillohen në sistem të eliminimit. Të gjitha ndeshjet zhvillohen sipas rregullave ndërkombëtare të lojës së basketbollit.

Neni 9

Në xhiron e I, II dhe të III, takohen të gjitha ekipet e Ligës së Parë, Ligës së Dytë dhe grupet e qytetarëve, ku ndaras zhvillojnë ndeshjet për Kupën e Ligës së Parë të Kosovës dhe Kupën e Ligës së Dytë të Kosovës.

Çiftet dhe ekipet që do të zhvillojnë ndeshjet si vendas do të fitohen në bazë të hedhjes së shortit.

Neni 10

Ekipet e ART Motion Superligës ndahen në katër grupe. Bartës të grupeve janë ekipet më të suksesshme në momentin e tërheqjes së shortit (pa marrë parasysh ndonjë ndeshje të mbetur apo të shtyrë). Renditja e mëtutjeshme e ekipeve të Superligës në grupe do të bëhet konform renditjes sipas sistemit të Bergerit. Në xhiron e parë si nikoqir do të luajnë ekipet më të suksesshme në momentin e tërheqjes së shortit, pas xhiros së XIV.

Në xhiron e dytë si nikoqir do të luajnë ekipet që në ndeshjet e para kanë qenë mysafir. Nëse të dy ekipet rivale në xhiron e parë kanë qenë vendas apo mysafirë, vendasi caktohet me short.

Në tetën e Finales (Final 8) së Kupës për meshkuj takohen:

Vërejtje: Bartësit e grupeve ndeshjet e tyre të para do të zhvillojnë në Final 8;

- I pari i Grupit A me të dytin e Grupit A, dhe i Pari i Grupit D me të dytin e grupit D;

- I pari i Grupit B me të dytin e Grupit B, dhe i Pari i Grupit C me të dytin e Grupit C;

- Në gjysmëfinale takohen:

Fituesi i Grupit A me fituesin e grupit D;

- Fituesi i Grupit B me fituesin e grupit C;

- Në finale takohen fituesit e gjysmëfinaleve (ekipi i cili është fitues i parë i gjysmëfinaleve është vendas në ndeshjen finale).

Skuadrat e femrave ndahen në dy grupe dhe bartës të grupeve janë dy ekipet më të suksesshme në momentin e tërheqjes së shortit. Fituesit e grupeve plasohen në finale.

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë



RUGOVE



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë



RUGOVE

Neni 11

Për kohën dhe vendin e zhvillimit të ndeshjes vendasit janë të obliguar të lajmërojnë Komesarin e Garave, ekipin mysafir, vëzhguesin, gjyqtarët së paku 48 orë para zhvillimit të ndeshjes. Mos përmbushja e këtij obligimi sanksionohet me përgjegjësitë e Rregullores Disiplinore dhe dënimin me gjobë prej 100 €.

Neni 12

Në ndeshjet e tetës së finales (Final 8) për meshkuj dhe femra shpenzimet e personave zyrtar dhe shpenzimet e tjera barten nga organizatori i ndeshjeve finale, kurse në ato kualifikuese ekipet vendase sipas tarifave ekzistuese në FBK.

Neni 13

Detyrat e vëzhguesit dhe të gjyqtarëve janë të njëjta si në ndeshjet e kampionatit

Neni 14

Ankesat për garat për Kupë duhet të paralajmërohen më së voni 15 minuta pas përfundimit të ndeshjes. Arsyetimi i ankesës duhet të dërgohet te Komesari i Garave më së largu 24 orë pas përfundimit të ndeshjes.

Ankesës në ndeshjen e Kupës duhet t'i bashkëngjitet edhe dëshmia e mjeteve të paguara sipas Propozicioneve të Garave të FBK-së.

Vëzhguesit janë të obliguar që në Raportin e ndeshjes të konstatojnë se është paraqitur ankesa.

Vendimi mbi ankesën në shkallën e parë merret në afat prej njëzetekatër (24) orëve dhe ju dorëzohet palëve me shkrim.

Në këtë vendim, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në organin e shkallës së dytë – Komisionin Arbitrar në afat prej dymbëdhjetë (12) orëve, i cili vendim do të merret në afat prej njëzetekatër (24) orëve.

Vendimi mbi ankesën në ndeshjen gjysmëfinale në shkallën e parë merret në afat prej katër (4) orëve dhe ju dorëzohet palëve me shkrim, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në organin e shkallës së dytë-KA, i cili vendimin do ta merr në afat prej tetë (8) orëve.

Neni 15

Nëse ekipi nuk paraqitet fare në ndeshjet e garave të Kupës së Kosovës do të dënohet me minus katër (4) pikë, në kampionatin e ligës përkatëse.

Neni 16

Ndeshjet Final 8 të Kupës së Kosovës dhe organizatorin e Final 8 Kupa e Kosovës në dy konkurrencat e cakton Bordi i FBK-së.

Neni 17

Faza përfundimtare zhvillohet në formë të turneut Final 8 për meshkuj, kurse femrat luajnë ndeshjen finale. Organizimin e fazës përfundimtare, Bordi i FBK-së mund t'ia besoj edhe ndonjërit prej klubeve apo agjencive të specializuara nën



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

kushtet që do të parashtrojë paraprakisht Bordi dhe me përzgjedhësin do të lidhet Kontrata.

Kushtet për fitimin e të drejtës së organizmit të Kupës i përcakton Bordi i FBK-së.

Neni 18

Çështjet të cilat nuk janë përfshirë me këto Propozicione, do të rregullohen sipas Propozicioneve të Garave, si dhe akteve tjera normative të FBK-së.

Neni 19

Interpretimin e këtyre Propozicioneve e bënë Bordi i FBK-së.

Faton Kurshumlija
Komesar i Garave

Arben Fetahu
Kryetar

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë

Federata e Basketbollit të Kosovës



RUGOVE